

Më
Dana

13 - 04 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRERGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Viti, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.638-3/17 të dt. 16.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarës [REDAKTUAR] me përfaqësuesin ligjor - prindin [REDAKTUAR] si dhe të pandehurin [REDAKTUAR] me datë 13.02.2018 mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari: [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] K. Viti, i pamartuar, me profesion kontabilist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDAKTUAR].

ËSHTË FAJTOR

Me date 03.04.2017, rreth orës 14:00, në rrugën “Vëllezërit Gërvalla” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës Mercedes, ngjyre hiri, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurin, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 par.1 të LSKRR-se, të market [REDAKTUAR] nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë si dhe merr veprimin e k’thimit në anën e djathtë pa u bindur mirë se nuk rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, për pasoj me rrotën e djathtë të anës së pasme e shkel në këmbë të majtë këmbësoren të dëmtuarën [REDAKTUAR], e cila pëson ndrydhje të regjionit talokrural të majtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

- ME DËNIM ME GJOBË, në lartësi prej 300€ /treqind euro/, të cilin gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 Euro, do të vuaj 1 /një/ ditë burgimi.
- E dëmtuara, [REDAKTUAR] me përfaqësuesin ligjor - prindin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontestin civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumë prej 60.88€ /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.638-3/17 të dt. 16.11.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 13.02.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza sipas të gjitha pikave të saj, i vetëdëshëm për pasojat e pranimi të fajësisë që mund të vijnë nga pranimi, ka shprehur pendimin të thellë për veprën penale të kryer, duke kërkuar falje publike të dëmtuarve në sallë, ndërsa gjykatës i propozon që ti i shqipton një dënim sa me të butë.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit, si dhe të marr parasysh faktin që pala e dëmtuar nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës [REDAKTUAR] prindi [REDAKTUAR] nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndërsa kërkesën pasurore juridike e ka paraqitur në kontest civil, ndërsa gjendja shëndetësore e vajzës është e mirë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i datës 19.05.2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore i datës 28.10.2017, raporti i aksidentit 2017- CF-182 i datës 03.04.2017, deklarata e të pandehurit e dt. 03.04.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës;

- të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cili është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri me datën 03.04.2017, rreth orës 14:00, në rrugën "Vëllezërit Gërvalla" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës Mercedes, ngjyre hiri, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurin, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 par.1 të LSKRR-se, të market [REDAKTUAR] nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë si dhe merr veprimin e k'thimit në anën e djathtë pa u bindur mirë se nuk rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, për pasoj me rrotën e djathtë të anës së eashme e shkel në këmbë të majtë këmbësoren të dëmtuarën [REDAKTUAR] e cila pëson ndrydhje të regjionit talokrural të majtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të pandehurit [REDAKTUAR] të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë me ane të veprimeve aktive dhe të kundërligjshme i pandehuri ka shkaktuar aksident nga pakujdesia duke e lënduar të dëmtuarën [REDAKTUAR] lëndime këto të përshkruana në ekspertizen mjeko ligjore dt. 28.10.2017.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në të gjitha fazat e procedurës penale ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i pandehuri deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale si dhe moshën shumë të re për të mituren.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzetë/€, si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88€ /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,

P.nr.2933/17 e dt. 13.02.2018

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.